

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA GLLOGOC

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-23-1507-2-1-1
Nr i brendshëm	611-23-021-211

Sa i përket tenderit për: Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

GOE : Alhena Law Office L.L.C & Kushtrim I. Bytyqi B.I

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bulevardi i Deshmoreve te Kombit

D1 hyrja 2-kati i III nr 8 Ulpianë

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 49 999 199

(Numri Telefonit)

N/A

(Numri i Faks-it)

Arber Fazliu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

arberfazliu01@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.07.2023

(Data e parashtrimit të kërkesës)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim: N/A

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KOMUNA GLLOGOC**, me date 01.03.2023 ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit**, si në vijim:

- ☐ Procedurë e hapur,
- ☐ Kontrate publike kornizë me një operator,
- ☐ Shërbime, Vlerë e madhe
- ☐ Vlera e parashikuar e kontratës 150,000.00 euro
- ☐ Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët me poentim.

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve i shkurtuar, data e dorëzimit 22.03.2023 ora:14:00,
Vendi: Zyra e Prokurimit

Takimi për hapjen e tenderëve me 22.03.2023 ora:14:00, ne platformën elektronikë të prokurimit.

Me date 07.04.2023 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm dhe të eliminuar.

Bashkëngjitur në këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde të tenderuesit të pa përgjegjshëm (të eliminuar).

Me datë 10.04.2023 dhe brenda afatit ligjorë, kemi paraqitur kërkesë për ri-shqyrtim në pajtim me kërkesat e nenit 108/A, të LPP-se, kundër vendimit të AK për dhënie të kontratës.
(Bashkëlidhur me këtë ankese gjëni edhe kërkesën për ri-shqyrtim të dorëzuar në AK).

Me datë 13.04.2023, kemi pranuar refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim si të pa bazuar (bashkëlidhur e gjëni vendimin e AK).

Me datë 18.04.2023, kemi paraqitur Ankese në OSHP.

Me datë 30.04.2023, kemi pranuar ekspertizën nr. 2023/0222 dhe mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së dhe në rastin konkret ankesa e parashtruar nga ne, është e bazuar dhe i propozon panelit shqyrtues të OSHP-se, që, të anuloj vendimin për dhënie dhe rastin të kthejë në Ri-vlerësim, për shkak të shkeljeve esenciale të LPP-se, (bashkëlidhur ekspertiza nr.2023/0222)

Me datë 14.06.2023, Paneli Shqyrtues i OSHP-se, sipas vendimit nr. OSHP: 2023/0222, nxjerr vendim që Ankesën të parashtuar nga ne të aprovoj të Bazuar, kurse vendimin e AK të anulohet dhe rastin të kthej në Ri-vlerësim për shkak të shkeljeve esenciale të LPP-se! (bashkëlidhur vendimi i OSHP-se 2023/0222)

Me datë 30.06.2023, AK në kundërshtim me Vendimin e OSHP-së, nxjerr vendim për dhënie të kontratës OE të Pa përgjegjshëm sikurse në rastin e parë, kurse neve na eliminon për kritere të cilat nuk kanë qenë te parapara në NJK dhe DT.

Prandaj, në përputhje me nenin 108/A të LPP-se, brana afatit ligjor ri-parashtrojmë kërkesë për Rishqyrtim në AK për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të LPP-se dhe në shkelje dhe mos respektim të vendimit të OSHP-së.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderit është bërë në mënyrë elektronike në vendin e caktuar dhe në kohën e caktuar.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pa kënaqur me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KOMUNA GLLOGOC** dhe në pajtim me nenin 108A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër;

- **Njoftimit B42, Letër standarde për tenderuesin e eliminuar 30.06.2023 dhe**
- **Njoftimit B58, Njoftim mbi Vendimit të AK të datës 30.06.2023**

Pretendojmë se **KOMUNA GLLOGOC**, përmes Komisionit për vlerësimin, krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së RI- vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin

e mëtejme do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par 1; 2 dhe 3.
- Neni 6, Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, par 1.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;
- Neni 51, Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, par 1
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, pika 1, par 1.1 dhe 1.2 dhe pika 56.3.
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, pika 1, par 1.1

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejme do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, par 40.2; 40.6; 40.12 dhe 40.13.
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d), (h) dhe (o).

III. Mos respektim të vendimit të OSHP-se, nr. OSHP: 2023/0222, të datës 14.06.2023!

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

- **Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore sa i përket: Formularit B42- Letrës standarde për tenderues te papërgjegjshëm (të eliminuar)**

E kundërshtojmë në tersi arsyetimin e AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar B42, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar, jo i mbështetur në dispozita ligjore të LPP-se dhe RrPP, ne tejkalojmë kompetencave ligjore, në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr. 2023/0222 dhe jashtë çdo parimi themelor apo etikes sa i përket objektivitetit, profesionalizmit dhe kompetencës profesionale.

SEPSE:

Autoriteti Kontraktues na eliminon nga aktiviteti i mëtejme i prokurimit jashtë kritereve të përzgjedhjes të parapara nga AK në NJ dhe DT, madje edhe kundër vendimit të OSHP-se, me arsyetimin se:

Eshte ne kundërshtim me kriterin nr 4 i cili ka te beje me sigurimin e procesit objektiv te mbrojtjes dhe perfaqsimi te komunes se Drenasit ne procedurat perkatese gjyqsore e te qenurit pale paditese apo e paditur , ku komuna e Drenasit eshte ne procedura gjyqsore ne 5 vitet e fundit e qe e vene ne dyshim objektivitetin e kesaj mbrojtje , perkatesisht perfaqsimi .

I njejti ne 5 vitet e fundit ka perfaqsuar palet ne procedure ku Komuna e Drenasit ka qene pale , rastet si ne vijim : C.Nr . 555/22, A.Nr 1932/18, C.Nr 88/21. Cn .Nr 1013/20, C .Nr .903/20, C.Nr .1039/20 , Nr 1014/20 .

Per me teper ne rastin ne fjale , pala ankuese ka edhe lende aktive ne procedure gjyqsore , ku i njejti mbron perkatesisht perfaqson palen kundërshtare te komuna e Drenasit eshte ne procedur gjyqsore e ne rastin hipotetik nese pala ankuesec do ta perzgjedh per ta perfaqesuar komunën ne rastin ne fjale (rrasti me C .NR.603/22) do ta kishte te pamundur ngase tashme sepse mbron interesat e pales kundërshtare andaj ne pamundesit te mbrojtjes se komunes ne kete rast gjyqsor , gjasat jan te medha qe ky rast te humbet ,nga i cili do ti shkaktoheshin humbje te medha buxhetit te komunes se Drenasit .

Arsyetimi i AK, është në kundërshtim me formularin-letërën standarde B42, për shkak se arsyetimi nuk ka dispozitiv, madje arsyetimi është i pa arsyeshëm dhe kundërshtim me dispozitat e par 56.3 të nenit 56, të e LPP-së, ne kundërshtim me dispozitat e par 40.2, 40.12, dhe 40.13, të nenit 40 të Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik si dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.2023/0222, sepse kjo çështje sa i përket eliminimit të pa drejte dhe ne kundërshtim me dispozitat e lartë cekura tani më është trajtuar edhe ne ekspertizën e ekspertit shqyrtues të OSHP-s, nr.2023/0222 dhe vendimit të OSHP-së nr.2023/0222, të datës 14.06.2023, për rastin e njëjtë dhe për pretendimin e njëjtë, **për me teper citojmë konstatimet e panelit shqyrtues në Vendim:**

Paneli shqyrtues pretendimet ankimore sa i përkasin eliminimit të OE ankues i klasifikon si të bazuara duke i mbështetur në kërkesat e DT dhe NJK, dispozita ligjore siç janë neni 56.3 i LPP, i cili citon: "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, po ashtu edhe në nenet 1, 6, 7 dhe 59 të LPP dhe dispozita e legjislacionit sekondar RRPP 001/2022, pa pasur nevojë që ato prapë të përshkruhen sepse ato janë të paraqitura në raportin e ekspertit shqyrtues dhe PSH i mbështet përgjigjet e dhëna në raportin e ekspertit shqyrtues.

Pra, në rastin konkret, AK vepron në kundërshtim të plotë dhe në shkelje të dispozitave të nenit par (d); (h) dhe (o), të par 97.1 të nenit 97 të rregullores 01/2022, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, për shkak të mosrespektimit të vendimit të OSHP-së si dhe për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit, për faktin se aplikon kriteret/kërkesa të cilat nuk kanë qene të parapara në NJK dhe DT.

Prandaj, të gjitha të konstatimet e lartcekura, njoftimin B42 për eliminim të ofertës tonë e bëjnë të pa qëndrueshëm, të pa drejtë, diskriminues dhe tendencioz dhe në shkelje të dispozitave ligjore, për shkak se, AK Hipotetizon përtej kriterëve të përzgjedhjes, kinse përfaqësuesi i kompanisë Alhena Law Office L.L.C, Arber Fazliu, ka raste si përfaqësues i palëve kundër Komunës së Drenasit.

AK duhet të ketë të qartë se, kriteri i përzgjedhjes nuk ka qene përfaqësuese i palëve, por kërkesa në NJK dhe DT ka qene: **që nuk ka qenë palë paditëse apo e paditur kundër komunës në 5 vitet e fundit.** Dhe, në rastin konkret përfaqësuesi i Alhena Law Office L.L.C, Arber Fazliu, nuk është **PALË PADITËSE APO E**

PADITUR kundër Komunës dhe ky është dallim esencial me atë se çfarë pretendon AK në arsyetim, madje kjo çështje është trajtuar edhe në ekspertizë të ekspertit shqyrtues dhe në vendimin e OSHP-së, nr.2023/0222 ku për këtë çështje ka vendim meritore nga OSHP-ja, për këtë rast.

Provë: Ekspertiza e ekspertit shqyrtues të OSHP-së nr.2023/0222

Provë: Vendimi i OSHP-se, PSH, nr.2023/0222.

▪ **Pretendimet lidhur me shkeljet e dispozitave ligjore sa i përket : Formularit B58 Njoftim mbi Vendimit te AK te datës 30.06.2023**

E kundërshtojmë në tersi vendimin e AK B52, për faktin se vendimi është në kundërshtim të plotë dhe në shkelje të dispozitave të LPP-se dhe RpPP, ne tejkalim të kompetencave ligjore dhe në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr. **2023/0222**, për shkak se OE Ardian I. Bajraktari B.I, Drenas, i ri-propozuar për kontratë nga ana e AK është i pa përgjegjshëm dhe në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes të parapara nga AK në NJK dhe DT, për faktin se edhe ekspertiza e Ekspertit Shqyrtues dhe pastaj vendimi i OSHP-së, OE Ardian I. Bajraktari B.I, Drenas e trajton të pa përgjegjshëm për shkak të kushtit administrativ të NJK dhe DT, sa i përket **kërkesës: dëshmi se ka përfunduar ose ka kontrate valide për formimin e shërbimeve juridike ne tri vitet e fundit**, e që OE në fjalë nuk e ka plotësuar këtë kriter të përzgjedhjes, sepse nuk ka ofruar dhe nuk ka dëshmi se ka përfunduar kontrata të shërbimeve juridike në tri vitet e fundit dhe rrjedhimisht **OE në fjalë është i pa përgjegjshëm**.

Për me teper, nese citojmë dispozitat nen par 2.16, të par 2 të nenit 105 të LPP-se citojmë: *Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.*

Pra, në rastin konkret kjo çështje është gjykar dhe ka vendim meritore nga OSHP-ja, prandaj ç’do tendencë tjetër e AK për ti dhene kahje tjetër me interpretime hipotetike, hipoteza dhe paragjykime, për ne janë të pa pranueshme dhe si te tilla do ti apelojme në cdo instancë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, sepse jemi duke e kerkuar të drejten tonë që na jap Ligji.

Dhe, rrjedhimisht, vendimi i AK është nxjerrë në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-se dhe RpPP, sa i përket kriterëve të përzgjedhjes të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, sepse shpërblen me kontratë OE të pa përgjegjshëm në kundërshtim me par 1 të nenin 51, nen par 1.1 dhe 1.2 të par 1 dhe par 6.3 të nenit 56 dhe nen par 1.1 të par 1 të nenit 60 të LPP-se, kurse neve na eliminon pa drejtësisht edhe pse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët në pajtim me kriteret e vlerësimit të parapara nga AK, në NJK dhe DT.

AK, me këtë veprim ka bërë shkelje të nenit neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, sepse nuk e trajton ofertën tonë në mënyre të barabar dhe të drejtë dhe në tërësinë e tij është diskriminues ndaj kompanisë tonë dhe favorizues ndaj kompanisë së propozuar për kontratë.

Për me tepër, AK edhe për kundër ofertës tonë e cila është e përgjegjshme dhe ka çmim me te ulët si dhe përkundër vendimit të OSHP-se nr.2023/0222 shpërblen me kontratë OE Ardian I. Bajraktari B.I, Drenas me çmim me të lartë, i cili është i pa përgjegjshëm dhe tanimë i konstatuar edhe nga ekspertiza e Ekspertit shqyrtues të OSHP-se dhe nga Vendimin e OSHP-se, e që këto veprime të AK janë shkelje të pakontestuar të dispozitave të par 1; 2 dhe 3 të nenit 1 dhe në shkelje të dispozitave të par 1 të nenit 6 të LPP-se, sepse qëllimi

primar i LPP-së është ruajtjen e Buxheti të AK dhe **vlera për para.**

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, zyrtaret përgjegjës të AK, gjatë ri-vlerësimit, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit, kanë bërë shkeljesh serioze të dispozitave Ligjore të LPP-së në vendim, sepse nuk kanë shfrytëzuar dispozitat ligjore që u jep Ligji i prokurimit Publik, për të korrigjuar vendimin e mëhershëm të kundërligjshëm, madje as vendimin e OSHP-se, nuk e ka marrë për bazë dhe nuk e ka trajtuar ne substancë, përveç që rastin e ka kthyer ne ri-vlerësim.

Thëne tutje, AK me të njëjtin arsyetim të pa arsyeshëm dhe të pa mbështetur në dispozita të LPP-se, nxjerr vendim të pa drejt dhe në kundërshtim e dispozitat e lartë cekura, prandaj, për ne është i pa pranueshëm vendimi i AK, sepse jemi palë me interes juridiko material sipas nenin 4.1.26 të LPP-së, jemi të përgjegjshme dhe kemi ofruar çmimin me te ulët në pajtim me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterëve të vlerësimit të parapara në NJK dhe DT.

Për me tepër, me këtë vendim, AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e par 1; 2 dhe 3 të nenit 1 dhe par 1 të nenit 6 të LPP-se, sepse çmimi i ofertuar i ofertës së GOE Alhena Law Office L.L.C & Kushtrim I. Bytyqi B.I Prishtinë është me çmim të peshuar në shumë prej **430.50€** dhe, është çmimi me i ulte ne raport me çmimin e OE Ardian I. Bajraktari B.I, Drenas të propozuar për kontrate me çmimin njësi të peshuar në shumë prej **832.98€**, madje është edhe i papërgjegjshëm, ku në këtë rast, Autoriteti kontraktues me këtë veprim dëmton rëndë buxhetin varfër e Republikës se Kosovës dhe te KOMUNËS në veçanti, i cili buxhet përbehet nga taksat e qytetareve te Republikës së Kosovës.

Veprimet e tilla të zyrtareve të AK, bien ndesh edhe me kodin penal të RK, për faktin se me këtë ri-vendim të AK janë konsumuar të gjitha elementet e veprës penale! Sepse qëllimi dhe dashja ekzistojnë dhe demi që i shkaktohet AK është fakt notor pasi që shihet që ne kundërshtim me dispozitat e LPP-së ka tendeca që te shpërblehet me Kontrate OE i cili nuk i plotëson kriteret e NJK dhe DT-së.

Dhe, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material, jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga KUVENDI KOMUNAL GLLOGOC, që kërkesën për ri-shqyrtim ta trajtoj me pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-se, RpPP dhe vendimi të **OSHP-se, nr.2023/0222**, ta trajtoj ne pajtueshmëri të plotë me kërkesat e parapara ne njoftim për kontratë dhe dosjes së tenderit si dhe të ketë në konsideratë vlerën për para, sepse ky është edhe qëllimi i LPP-së.

Përfundim:

Kërkojmë nga AK, **KUVENDI KOMUNAL GLLOGOC**, që:

- ✓ Të aprovoj Kërkesën për ri-rishqyrtim të bazuar;
- ✓ Të anuloj vendimin për dhënie te kontratës;
- ✓ Te kthej rastin ne rivlerësim dhe vlerësimi të bëhet në pajtim me LPP dhe Rregullat dhe RpPP dhe Vendimit të OSHP-se, nr. nr.2023/0222
- ✓ Te na shpërblej me kontratë sepse jemi te përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmim me te lirë.

Mbetemi me shpresë se Kërkesa për Ri-shqyrtim do të shqyrtohet pozitivisht.

Me respekt,

GOE “Alhena Law Office” L.L.C , “Kushtrim Bytyqi” BI.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzime administrative. Shpenzimet e ankimimit 350€
--

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- e) **Provë:** Ekspertiza e ekspertit shqyrtues të OSHP-se, nr.2023/0222
- f) **Provë:** Vendimi i OSHP-se, nr. nr.2023/0222